



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit
Ministartstvo za Saobraćaj, Poštu i Telekomunikacije
Ministry of Transport and Communications

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 4 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007 dhe nenit 317 (5), Ligjit Nr. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor.

Me qëllim të përcaktimit të mënyrës dhe procedurës për kryerjen e kontrollimit teknik të automjeteve.

Nxjerr :

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 2008/13
KONTROLLIMI TEKNIK I AUTOMJETVE

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet mënyra e ofrimit të shërbimit për kontrollim teknik të automjeteve dhe mjeteve bashkangjitive (në tekstin e mëtejme automjetet) me masë deri në 3,5t dhe mbi 3,5t si dhe motoçikletave, kriteret dhe procedura për lëshimin, pezullimin dhe revokimin e licencës për ofrimin e shërbimit të kryerjes të kontrollimit teknik të automjeteve.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kontrollimi teknik i automjetit bëhet për të vërtetuar se automjeti i plotëson apo nuk i plotëson kushtet teknike për pjesëmarrje në komunikacionin rrugor.

2. Kryerjen e kontrollimit teknik të automjeteve e bëjnë Qendrat e Kontrollimit Teknik të Automjeteve (në tekstin e mëtejme Qendra) të licencuara nga Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit.

Neni 3

Mënyra e kontrollimit teknik të automjetit

1. Kontrollimi teknik i automjeteve mund të jetë: kontrollimi teknik i rregullt , periodik dhe i jashtëzakonshëm.

1.1. Kontrollimi teknik i rregullt bëhet pas kalimit të afatit të regjistrimit të automjetit dhe kryhet një herë në vit.

1.2. Kontrollimi teknik periodik bëhet në afate të caktuara periodike çdo gjashtë (6) muaj për këto kategori:

1.2.1. automjetet e transportit publik

1.2.2. automjetet e transportit për mallra me masë mbi 7.5 t

1.2.3. automjetet e transportit të mallrave të rrezikshme

1.2.4. automjetet e zjarrfikësve

1.2.5. automjetet e policisë

1.2.6. automjetet e ambulancës

1.2.7. automjetet për aftësimin e kandidatëve për shofer (auto shkollat)

1.2.8. auto-taksitë dhe

1.2.9. auto-rent-a-car.

1.3. Kontrollimi teknik i jashtëzakonshëm ka për qëllim verifikimin e gjendjes së rregullsisë teknike të automjetit sipas urdhëresës të personit zyrtar të autorizuar polici) nga Policija.

Neni 4

Veprimet përgaditore

1. Qendra para fillimit të kontrollimit teknik, bënë evidentimin e automjetit në librin e evidencës dhe plotësimi i formularit të procesverbalit ku bëhet krahasimi i të dhënave me gjendjen faktike dhe i dokumenteve të ofruara.

2. Nëse të dhënat nuk përputhen ose ekziston dyshimi mbi mospërputhshmërinë e tyre, kontrollimi teknik i automjetit nuk mund të kryhet, atëherë palës i jepen udhëzime lidhur me procedurën e mëtejme.

Neni 5

Llojet e kontrollimeve teknike

1. Automjeti i cili i nënshtrohet kontrollimit teknik të rregullt dhe periodik duhet të jetë i pastër.

2. Kontrollimi teknik i rregullt dhe periodik bëhet në automjet të pangarkuar ndërsa kontrollimi teknik i jashtëzakonshëm mund të bëhet edhe në automjet të ngarkuar.

3. Në vijën e kontrollimit teknik të automjeteve dhe brenda objektit të qendrës nuk lejohet të jenë të pranishme automjetet të cilat nuk i nënshtrohen kontrollimit teknik.

Neni 6 **Evidentimi i parregullsive**

1. Nëse gjatë kontrollimit teknik të automjetit hasët në parregullsi, ato evidentohen në librin e evidencës të kontrollimit teknik, në rubrikën e cekur për konfirmimin e rregullsisë teknike dhe në formularin e procesverbalit.

2. Në ato raste kur automjeti ka bërë ndryshime me atest atëherë qendra obligohet që një kopje të atestit dhe librezës t'ia bashkëngjies procesverbalit të lëndës përkatëse.

3. Certifikatën mbi konfirmimin e testit të rregullsisë i nënshkruan udhëheqësi i qendrës, në mungesë të tij i nënshkruan me autorizim kontrolluesi i parë (autorizimi duhet të jetë i dhënë në ditën paraprake nga udhëheqësi i qendrës ose të njëjtën ditë për secilën vijë të kontrollimit teknik).

4. Udhëheqësi i Qendrës e nënshkruan testin e rregullsisë teknike i cili duhet të jetë në njërin prej gjuhëve zyrtare dhe të përmbaj:

4.1. numrin rendor nga libri i evidencës

4.2. emrin dhe mbiemrin e pronarit

4.3. markën dhe tipin e automjetit

4.4. numrin e tabelave të automjetit

4.5. numrin e shasis

4.6. numrin e km të kaluara të automjetit

4.7. limitet e testit të rregullsisë teknike

5. Qendrat të cilat i kanë aparaturën e njëjtë duhet të kenë programin unik të testit të rregullsisë teknike (të kompletuara me të gjitha parametrat – limitet), terminologjia të jetë e njëjtë (p.sh. pllaka shkelëse, amortizorët etj.)

6. Certifikata mbi rregullsinë teknike të automjetit e nënshkruar nga udhëheqësi i qendrës duhet të fotokopjohet dhe të i bashkëngjitet lëndës përkatëse.

Neni 7 **Mënjanimi i parregullsive**

1. Plotësimi i të gjitha të dhënave në certifikatë dhe procesverbal bëhet me kompjuter.

2. Pronari ose personi i autorizuar i automjetit duhet që në afat prej shtatë (7) ditëve t'i mënjanoj parregullsitë dhe automjetin ta kthej në Qendër me riparimet e kryera.

3. Nëse riparimi nuk bëhet brenda afatit prej shtatë (7) ditëve atëherë i njëjti automjet i nënshtrohet kontrollimit të plotë teknik.

4. Qendra është e detyruar të informojë policinë dhe inspektoratin e MTPT – së nëse automjeti nuk paraqitet për kontrollim teknik pas kalimit të afatit të paraparë në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 8

Mënyrat e kontrollimit të Automjetit

1. Kontrollimin teknik të automjetit e bëjnë dy (2) kontrollues (inspektues) të cilët gjatë tërë kohës së kontrollimit duhet të jetë prezentë.

2. Pas përfundimit të kontrollimit kontrolluesi e bënë vlerësimin e automjetit i cili e nënshkruan procesverbalin me të cilin konfirmon se është kryer kontrollimi teknik i automjetit në përputhshmëri me aktet ligjore.

3. Kontrolluesit e bëjnë shikimin dhe kontrollimin teknik të automjetit në mënyrë të pavarur, pa ndikim të pronarit të automjetit, të udhëheqësit të vet apo personit tjetër.

4. Gjatë kontrollimit teknik të automjetit, automjetin atë e drejton kontrolluesi i cili duhet të jetë i aftësuar për drejtimin e kategorisë të automjetit përkatës.

Neni 9

Përmbajtja e procesit

Procesi i kontrollimit teknik të automjetit përfshin kontrollimin dhe rregullsinë e mekanizmave si vijon:

- 1.1. Kontrollimin e të dhënave të automjetit.
- 1.2. Kontrollimin vizuel të gjendjes së përgjithshme të automjetit.
- 1.3. Kontrollimin e motorit dhe pajimeve të transmisionit.
- 1.4. Kontrollimin e shasisë dhe kapacitetit bartës.
- 1.5. Kontrollimin e mekanizimit drejtues.
- 1.6. Kontrollimin e mekanizmit të frenimit.
- 1.7. Kontrollimin e dritave dhe pajimeve të sinjalizimit të dritës.
- 1.8. Kontrollimin e mekanizmave për dukshmëri normale/shikimi.

1.9. Kontrollimin e mekanizmave për dhënien e sinjaleve me zë dhe zhurmës së automjetit.

1.10. Kontrollimin e mekanizmit për kontroll dhe dhënien e sinjaleve (tabelat kontrolluese).

1.11. Kontrollimin e sistemit për lirim të gazrave.

1.12. Kontrollimin e mekanizmave lidhës të mjeteve motorike me rimorkio.

1.13. Kontrollimin e pajimeve të tjera të automjetit të rëndësishëm për sigurinë në trafik.

1.14. Kontrollimin e pajisjeve rezervë të automjetit.

Neni 10 **Kontrollimi i të dhënave**

Kontrollimi i të dhënave për automjetin përfshin:

1.1. Emri dhe mbiemrin i/e pronarit- es.

1.2. Numrin e tabelave të regjistrimit.

1.3. Markën / tipin.

1.4. Ngjyrën.

1.5. Numrin e shasisë.

1.6. Ndërtimi i automjetit.

1.7. Vitin e prodhimit.

1.8. Numrin e ulëseve.

1.9. Kapacitetin bartës.

1.10. Kapacitetin e përgjithshëm.

1.11. Masën pa ngarkesë.

1.12. Masën maksimale bartëse të lejuar.

1.13. Llojin e motorit.

1.14. Vëllimin e motorit në cm³.

1.15. Numrin e boshteve /për rimorkio.

1.16. Numrin e boshteve lëvizëse.

Neni 11

Pajisjet e transmisionit

Pajimet e transmisionit të motorit përfshijnë lidhjen e motorit dhe mekanizmit të transmisionit me shasinë.

Neni 12

Shasia dhe kapaciteti bartës

Kontrollimi i shasisë dhe kapacitetit bartës përfshin:

- 1.1. Shasinë dhe dëmtimet mekanike të kornizës.
- 1.2. Lidhjet e rrotave dhe amortizatorëve me shasi.
- 1.3. Rrotat dhe oscilimet e rrotave.
- 1.4. Kontrollimin e drejtimit të rrotave të përparme.

Neni 13

Përfshirja e kontrollit të mekanizmave

Kontrollimi i mekanizimit drejtues përfshinë:

- 1.1. Dëmtimet mekanike.
- 1.2. Lidhjen e kutisë drejtuese me mbajtësin.
- 1.3. Dëmtimin e pjesëve të gomës.
- 1.4. Mbylljen (shtypja) e pajimit të sistemit drejtues.
- 1.5. Tolerancën në kutinë drejtuese, këndi bosh i timonit duhet të jetë: $\leq \pm 15$, shkallë (30 shkallë).
- 1.6. Tolerancën në gjeometrinë shkelëse të rrotave në kufijtë ≤ 12 m/km.

Neni 14

Përfshirja e kontrollit të mekanizmit frenues

Kontrollimi i mekanizmit frenues përfshinë:

- 1.1. Dëmtimin mekanik në mekanizmin e frenimit.
- 1.2. Dëmtimin e pjesëve të gomës.
- 1.3. Mbyllja (shtypja) në mekanizmin e frenimit.
- 1.4. Lëvizja e komandave dhe zëvendësimi përpara.

- 1.5. Frenin ndihmës-parkues.
- 1.6. Rregullatorin për përshtatjen e intensitetit të frenimit.

Neni 15 **Kontrolli i mekanizmit për dukshmëri**

Kontrollimi i mekanizmit për dukshmëri normale përfshinë:

- 1.1. Xhamin e përparmë dhe xhamat e dritave.
- 1.2. Fshesat e xhamave.
- 1.3. Pasqyrat e shikimit (retrovizorët).

Neni 16 **Kontrolli i mekanizmit për sinjale me zë dhe zhurmës**

Kontrollimi i mekanizmave për dhënien e sinjaleve me zë dhe zhurmës së automjetit përfshinë:

- 1.1. Forcën e mekanizmit akustik për shenjat akustike.
 - 1.1.1. Automjetet e udhëtareve dhe motoçikleta 76 dB (A)
 - 1.1.2. Kamionët e vegjël 80 dB (A)
 - 1.1.3. Automjetet e rënda 93 dB (A)
- 1.2. Kufirin e lejuar të zhurmës së jashtme për këto kategori të automjeteve :
 - 1.2.1. automjetet e udhëtarëve dhe të kombinuara 84 dB (A);
 - 1.2.2. automjetet transportuese dhe autobusët me masë deri 3.5t, 85 dB (A);
 - 1.2.3. automjetet transportuese dhe autobusët me masë mbi 3.5 t, 89 dB (A)

Neni 17 **Kontrolli i mekanizmit për dhënien e sinjaleve**

Kontrollimi i mekanizmit për kontroll dhe dhënien e sinjaleve përfshinë:

- 1.1. Tabela kontrolluese dhe instrumentet.
- 1.2. Tahografi për automjetet e transportit.

Neni 18
Kontrollimi i mekanizmit lidhës

Kontrollimi i mekanizmit lidhës të mjeteve motorike me rimorkiot përfshinë:

- 1.1. Dëmtimin mekanik.
- 1.2. Mekanizmin e siguresës së lidhjes.
- 1.3. Hapësirën e mjaftueshme të mekanizmi për lidhje me automjetin tërheqës.

Neni 19
Normat teknike për efikasitetin e sistemit të frenimit

1. Normat teknike për efikasitetin e sistemit të frenimit për automjetet dhe rimorkiot të testuar në kushte statike të testimit në cilindra për testimin e forcës së frenimit janë dhënë në tabelën në vijim:

KATEGORIJA E AUTOMJETEVE	Freni i punës			Freni ndihmës		
	Koeficienti i frenimit $z \geq [\%]$	Forca e aktivizimit		Koeficienti i frenimit $z \geq [\%]$	Forca e aktivizimit	
		Aktivizimi me këmbë $F \leq [\text{daN}]$	Aktivizimi me dorë $F \leq [\text{daN}]$		Aktivizimi me këmbë $F \leq [\text{daN}]$	Aktivizimi me dorë $F \leq [\text{daN}]$
L ₁ , L ₂ (mopedët)	40	50	20	16	50	20
L ₃ , L ₄ , L ₅ (motoc kletat)	45	50	20	16	50	20
M ₁ (automjetet personale)	50	50	-	16	50	40
M ₂ , M ₃ (autobusat)	45	70	-	16	70	60
N ₁ , N ₂ , N ₃ (automjetet transportuese)	45	70	-	16	70	60
O ₁ , O ₂ , O ₃ , O ₄ (rimorkiot)	40	$P_M \leq 6,5 \text{ bar}$		-	-	-
SHENJA	PËRSHKRIMI I KATEGORIVE					
L	MOPEDËT DHE MOTOQIKLETAT Automjetet rrugore me më pak se 4 rrotë					
L ₁	Automjetet me 2 rrotë, me vëllim punues të motorit $\leq 50 \text{ cm}^3$ dhe shpejtësi $\leq 50 \text{ km/h}$					
L ₂	Automjetet me 3 rrotë, me vëllim punues të motorit $\leq 50 \text{ cm}^3$ dhe shpejtësi $\leq 50 \text{ km/h}$					
L ₃	Automjetet me 2 rrotë, me vëllim punues të motorit $> 50 \text{ cm}^3$ dhe shpejtësi $> 50 \text{ km/h}$					
L ₄	Automjetet me 3 rrotë, me rrotat e vendosura simetrikisht në raport me boshtin gjatësor të automjetit, me vëllim punues të motorit $> 50 \text{ cm}^3$ dhe shpejtësi $> 50 \text{ km/h}$					
L ₅	Automjetet me 3 rrotë, me rrotat e vendosura simetrikisht në raport me boshtin gjatësor të automjetit, me vëllim punues të motorit $> 50 \text{ cm}^3$ dhe shpejtësi $> 50 \text{ km/h}$					
M	AUTOMJETET PERSONALE DHE AUTOBUSAT Automjetet për bartjen e personave me së paku 4 rrotë gjegjësisht automjetet me tri rrotë nëse masa më e madhe e lejuar $> 1000 \text{ kg}$.					
M ₁	Automjetet për bartjen e personave të cilat përpos ulëses së shoferit kanë më së shumti edhe 8 ulëse					
M ₂	Automjetet për bartjen e personave të cilat përpos ulëses së shoferit kanë më shumë se 8 ulëse dhe masa më e madhe e lejuar $\leq 5000 \text{ kg}$					
M ₃	Automjetet për bartjen e personave të cilat përpos ulëses së shoferit kanë më shumë se 8 ulëse dhe masa më e madhe e lejuar $> 5000 \text{ kg}$					
N	AUTOMJETET TRANSPORTUESE Automjetet transportuese për bartjen e ngarkesës me së paku 4 rrotë, gjegjësisht automjetet me tri rrotë nëse masa më e madhe e lejuar $> 1000 \text{ kg}$					
N ₁	Automjetet transportuese për bartjen e ngarkesës me masë më të madhe të lejuar $\leq 3500 \text{ kg}$					
N ₂	Automjetet transportuese për bartjen e ngarkesës me masë më të madhe të lejuar $> 3500 \text{ kg}$ dhe $< 12000 \text{ kg}$					
N ₃	Automjetet transportuese për bartjen e ngarkesës me masë më të madhe të lejuar $> 12000 \text{ kg}$					
O	MJETET QË BASHKANGJITEN Rimorkiot duke përfshirë edhe gjysërrimorkiot					
O ₁	Rimorkiot me një bosht me masë më të madhe të lejuar $< 750 \text{ kg}$, përveç gjysërrimorkiove					
O ₂	Rimorkiot me masë më të madhe të lejuar $\leq 3500 \text{ kg}$ përveç rimorkiove të kategorisë O ₁					
O ₃	Rimorkiot me masë më të madhe të lejuar $> 3500 \text{ kg}$ mirëpo $\leq 10000 \text{ kg}$					
O ₄	Rimorkiot të cilave masa më e madhe e lejuar është $> 10000 \text{ kg}$					

2. Diferenca e forcës së frenimit për rrotat në boshtin e njëjtë nuk guxon të jetë më e madhe se 20% duke llogaritur në forcën maksimale.

Neni 20

Kontrolli i dritave dhe sinjalizimit

Kontrollimi i dritave dhe i pajimeve të sinjalizimit përfshinë:

1.1. Mekanizmin e dritave:

1.1.1. Dritat (gjata, shkurta).

1.1.2. Dritat e mjegullës.

1.1.3. Dritat për lëvizje prapa.

1.1.4. Dritat e lëvizshme-rotative

1.2. Pajimi për shënjimin dhe sinjalizimin e automjetit përfshinë:

1.2.1. Dritat për shënimin e automjetit.

1.2.2. Dritat e pasme.

1.2.3. Dritat e parkimit.

1.2.4. Treguesit e drejtimit.

1.2.5. Katadiopterët.

1.2.6. Dritat e frenimit.

1.2.7. Pajimet për aktivizimin e katër sinjaleve të drejtimit.

1.2.8. Fuqia e ndriçimit duhet ti ketë këta kufij (parametra):

1.2.8.1. për motoçikleta $1 \div 2$ lux, për dritat e mesme ≥ 16 lux.

1.2.8.2. për vetura $1 \div 2$ lux, për dritat e mesme, $48 \div 64$ lux.

1.2.8.3. për automjetet e rënda transportuese dhe autobus vlejné të njëjtat vlera të cilat janë të cekura për vetura.

Neni 21

Lirimi i gazrave të motorëve

1. Motorët me djegie të brendshme të automjeteve, përveç mopedëve, mopedëve me tri rrotë, motoçikletave, motoçikletave me rimorkio anësore, motoçikletave me tri rrotë, katërçikletave të lehta, katërçikletave, makinave të punës, traktorëve dhe automjeteve të forcave të armatosura të Republikës së Kosovës, përveç automjeteve personale dhe automjeteve të kombinuara, nuk duhet të lëshojnë në atmosferë gazra:

2. Motorët me benzinë pa katalizatorë dhe sondet λ , përkatësisht motorët me benzinë me katalizatorë, por pa sonde λ – koncentrimi i monoksid karbonit (CO), në shpejtësinë e sjelljes së motorit me ecje të zbrazët, nuk duhet të tejkalojnë;

2.1. (4,5%) të pjesëmarrjes vëllimore (pa automjetet që janë prodhuar më 1986 e më të vjetra) në temperaturë vaji motorësh së paku 80°;

2.2. (3,5%) të pjesëmarrjes vëllimore (për automjetet e prodhuara më 1987 e më të reja) në temperaturë vaji motorësh së paku 80°.

3. Motorët me benzinë me katalizatorë të rregulluar të veprimit të trefishtë – koncentrimi i monoksid-karbonit (CO), pasi që motori ka arritur temperaturë pune në shpejtësi të sjelljes me ecje të zbrazët, nuk duhet të tejkalojnë vlerën e përcaktuar nga ana e prodhuesit të automjetit. Temperatura e punës e motorit dhe shpejtësia e rrotullimeve me ecje të zbrazët duhet të jenë të përcaktuara nga prodhuesi i automjetit.

4. Koncentrimi i monoksid-karbonit (CO) dhe vlera e faktorit dritë (λ) gjatë një shpejtësie të shtuar të rrotullimeve të motorit, nuk duhet të tejkalojnë vlerën e përcaktuar nga prodhuesi i automjetit. Shpejtësia e rritur e rrotullimeve të motorit duhet të jetë e përcaktuar nga prodhuesi i automjetit. Në qoftë se nuk janë të njohura të dhënat e prodhuesit, përmbajtja e monoksid-karbonit (CO) dhe vlera e faktorit dritë (λ) nuk duhet të tejkalojnë:

4.1. $CO \leq 0,5\%$ të pjesëmarrjes vëllimore, në temperaturë vaji të motorit së paku 80° C dhe në shpejtësi të rrotullimeve të motorit me ecje të zbrazët;

4.2. $CO \leq 0,3\%$ të pjesëmarrjes vëllimore, $\lambda = 1,00 \pm 0,03$, në temperaturë të vajt motorik së paku 80° C dhe shpejtësi të rrotullimeve të motorit prej 2500 deri 3000 min⁻¹.

5. Motorët dizelë – pasi që motori ka arritur temperaturë pune të përcaktuar nga prodhuesi i automjetit, koeficienti i mesëm i nxirjes së gazit të lëshuar (k) pas tri a më shumë shpejtetimeve të lirshme të motorit të pangarkuar nga shpejtësia e rrotullimit me ecje të zbrazët deri në shpejtësinë më të madhe të rrotullimit nuk duhet të tejkalojë vlerën e përcaktuar nga prodhuesi i automjetit. Në qoftë se të dhënat e prodhuesit për koeficientin e mesëm të nxirjes dhe temperaturën e punës së motorit nuk janë të njohura, koeficienti i mesëm i nxirjes së gazit të lëshuar (k) nuk duhet të tejkalojë vlerën:

5.1. $k \leq 2,5$ m⁻¹, në temperaturë të vajt motorik së paku 80° C (për motorët pa rimbushje),

5.2. $k \leq 3,0$ m⁻¹, në temperaturë të vajt motorik së paku 80° C (për motorët me rimbushje).

6. Sasitë e materieve të rrezikshme të shënuara në paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të bëjnë me këto automjete:

6.1. automjetet të pajisura me motor dyaktësh benzine;

6.2. automjetet të pajisura me motor benzine, në qoftë se janë prodhuar para 1970;

6.3. automjetet të pajisura me motor benzine, në qoftë se kanë shpejtësi konstruksioni më të vogël se 50 km/h;

6.4. automjetet të pajisura me motor dizel, në qoftë se janë prodhuar para vitit 1980;

6.5. automjetet të pajisura me motor dizel, në qoftë se kanë shpejtësi konstruksioni më të vogël se 30 km/h;

6.6. automjetet të vëna në lëvizje me motor lëvizjeje alternative apo me burim energjie(hidrogjen, metan, propanbutan, karburante qelizash, alkool e të ngj.).

7. Nëse automjeti nuk i arrin parametrat e parapara në paragrafin 1. dhe 2. këtij neni nuk merret parasysh për rezultat me rastin e kontrollimit teknik të automjetit.

Neni 22

Kontrollimi i pajimeve të automjeteve

Kontrollimi i pajimeve të tjera të automjeteve të rëndësishme për sigurinë në trafik përfshinë:

1.1. Hapësirën e brendshme të automjetit.

1.2. Dyert dhe çelësat e dyerve.

1.3. Pneumatikët:

1.3.1. Duhet të vërtetohet nëse pneumatikët në të njëjtin bosht, janë të njëjtë:

1.3.1.1. sipas tipit (të verës apo të dimrit),

1.3.1.2. konstruksionit (radial, diagonal dhe sharat të njëjta në të njëjtin bosht),

1.3.1.3. dimensionit dhe kapacitetit të masës

1.3.2. Shkalla e thellësisë së pneumatikëve matet me thellëmatës. Thellësia e lejuar e larave në pneumatikë në tërë sipërfaqen shkelëse duhet të jetë së paku:

1.3.2.1. (1,6 mm.) për automjetet e udhëtarëve,

1.3.2.2. (2 mm.) për autobusë dhe automjetet transportuese,

1.3.2.3. (4 mm.) nëse pneumatikët konsiderohen si përgatitje dimërore.

1.4. Amortizatorët:

1.4.1. efikasiteti i amortizimit duhet të jetë $\geq 20 \%$.

1.4.2. amplitude maksimale e oscilimit ≤ 38 Mm (njësia e përcaktuar prej prodhuesit që do të thotë manometër).

1.5. Mbrojtësin nga balta.

1.6. Baterinë.

1.7. Pajimet shtesë për dritë dhe për automjetet e rënda.

Neni 23

Kontrollimi i pajisjeve të automjeteve

Kontrollimi i pajisjeve rezervë të automjetit përfshinë:

- 1.1. Çelësin e rrotave.
- 1.2. Ngritësen mekanike ose hidraulike.
- 1.3. Gomën rezervë.
- 1.4. Aparatin e fikjes së zjarrit.
- 1.5. Trekëndëshin.
- 1.6. Ndhimën e parë.
- 1.7. Çekanin për thyerje të xhamit të autobusët.
- 1.8. Dritat rezervë.
- 1.9. Pajimet e dimrit-zinxhirët.

Neni 24

Autorizimi

Kontrollimi teknik i automjetit i cili ka të instaluar sistemin për furnizim me lëndë djegëse të gaztë mund të kryhet vetëm në Qendrën e cila përveç licencës ka edhe autorizimin nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacioni për kryerjen e kësaj veprimtarie.

Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit do ti cakton kushtet tekniko-teknologjike dhe kualifikimet adekuate te personelit si kusht për marrjen e këtij autorizimi nga Qendra.

Neni 25

Autorizimi

Kontrollimi teknik i automjetit i cili bart mallra të rrezikshme mund të kryhet vetëm në Qendrën e cila përveç licencës ka edhe autorizimin nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacioni për kryerjen e kësaj veprimtarie.

Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit do ti cakton kushtet tekniko-teknologjike dhe kualifikimet adekuate te personelit si kusht për marrjen e këtij autorizimi nga Qendra.

Neni 26

Defektet e pajisjeve

1. Nëse vjen deri tek defekti në pajisjet dhe pajimet për kryerjen e kontrollimeve teknike të automjeteve qendra është e obliguar që ta ndërprejë menjëherë punën dhe në vend të dukshëm me shkronja të mëdha të vendos mbishkrimin “PËR SHKAK TË DEFEKTIT NË PAJISJE DHE PAJIME NUK PUNOJMË”.

2. Qendra duhet të informojë menjëherë për defektin në pajisje dhe pajime personat e autorizuar Inspektoriatin në Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit.

3. Para fillimit të punës së Qendrës personat e autorizuar në Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit duhet ta bëjnë verifikimin e mënjanimit të defektit brenda dy ditëve të punës.

Neni 27

Mbajtja e evidencës për kontrollimin teknik të automjeteve

1. Qendra është e obliguar që të mbajë dhe të ruaj shënimet në librin e evidencës, formularin e procesverbalit, testin e rregullsisë teknike, certifikatën për rregullsinë teknike të automjetit, kopjen e pagesës, fotografinë e automjetit për çdo automjet të kontrolluar në vijën e kontrollimit teknik, raportet e punës dhe duhet ti ruaj së paku dhjetë (10) vite

2. Qendra duhet të pajiset me aparat digjital i cili përdoret për fotografimin e automjeteve të cilat i nënshtrohen kontrollimit teknik.

3. Fotografimi i secilit automjet të bëhet nga ana e përparme e automjetit duke përfshirë targa e automjetit në momentin e kontrollimit në cilindra dhe njëri kontrollues të jetë brenda në automjet. Fotografia e automjetit i bashkëngjitet secilës lëndë përkatëse. Koha dhe data ne fotografim të jetë në përputhshmëri me kohën e testit të rregullsisë teknike.

Neni 28

Përmbajtja e librit të evidencës

1. Libri i evidencës i kontrollimit teknik të automjetit duhet të përmbajë:

1.1. Numrin rendor.

1.2. Datën dhe kohën e kryerjes së kontrollimit teknik.

1.3. Emrin, mbiemrin e/i pronarit-ës.

1.4. Numrin e tabelave të regjistrimit (nëse është i regjistruar).

1.5. Markën dhe tipin e automjetit që i nënshtrohet kontrollimit.

1.6. Numrin e shasisë së automjetit që i nënshtrohet kontrollimit.

1.7. Rubrikën për vërejtje, psh. në rast atesti atëherë në këtë rubrikë ceket qëllimi pse ju ka bërë atesti automjetit dhe numri i atestit.

1.8. Konfirmimin mbi gjendjen teknike të automjetit (pozitive dhe negative).

2. Për secilën vijë të kontrollimit teknik shënimet mbahen në librin e evidencës të veçantë.

3. Çdo ditë në fund të orarit të punës mbyllet libri i evidencës.

4. Në fillim të çdo viti kalendarik qendra obligohet të filloj punë me libra të ri të evidencës.

4. Në fillim të çdo viti kalendarik qendra obligohet të filloj punë me libra të ri të evidencës.

5. Në fund të çdo viti kalendarik qendra obligohet të mbyllë librat e evidencës.

Neni 29

Përmbajtja e procesverbalit

Formulari i procesverbalit për kontrollimin e kryer teknik të automjetit duhet të përmbajë:

1.1. Numrin e regjistrit nga libri i evidencës.

1.2. Datën e kryerjes së kontrollimit teknik.

1.3. Emri mbiemri e/i pronarit-es .

1.4. Numrin e tabelës së regjistrimit.

1.5. Markën/tipin.

1.6. Numrin e shasisë (VIN numrin).

1.7. Ndërtimin e automjetit .

1.8. Vitin e prodhimit.

1.9. Vendin e prodhimit.

1.10. Vëllimin e motorit.

1.11. Masën bartëse të lejuar.

1.12. Masën pa ngarkesë.

1.13. Masën e përgjithshme.

1.14. Numrin e ulëseve.

1.15. Ngjyrën e automjetit.

1.16. Numrin e boshteve ngasëse.

- 1.17. Numrin e boshteve të ngastra.
- 1.18. Çengelen e automjetit.
- 1.19. Llojin e motorit.
- 1.20. Fuqinë e motorit.
- 1.21. Konfirmimin mbi kontrollimin e kryer.
- 1.22. Numri i dyerve të automjetit.

Neni 30 **Certifikata mbi rregullsinë teknike**

1. Qendra është e detyruar t'i lëshoj palës certifikatën mbi rregullsinë teknike të automjetit.
2. Certifikata mbi rregullsinë teknike të automjetit duhet të përmbajë të dhënat e shënuara në nenit 29.
3. Nëse automjeti është teknikisht në rregull certifikata dhe procesverbali vërtetohet me vulë ngjyrë të gjelbër ndërsa nëse automjeti teknikisht nuk është në rregull certifikata dhe procesverbali vërtetohet me vulë ngjyrë të kuqe.
4. Qendra është e obliguar që me kërkesën e palës ose personit të autorizuar të jap një kopje të procesverbalit.

Neni 31 **Përcaktimi i mostrave të dokumentacionit**

Formën, përmbajtjen dhe shpërndarjen e librit të evidencës, formularit të procesverbalit, certifikatës dhe vërtetimit periodike e përcakton Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe e autorizon një kompani për shtypjen e formularëve.

Neni 32 **Përgatitja e raporteve**

1. Qendra është e obliguar të përgatit raportet, mujore, gjashtëmujore dhe vjetore.
2. Raportet duhet të përmbajnë llojin, vitin e prodhimit, numrin e shasisë, tabelat e automjetit dhe kalueshmërinë e automjeteve të kontrolluara, dhe numrin e kontrollimeve teknike të rregullta, periodike dhe të jashtëzakonshme.
3. Raportet dorëzohen në fillim të çdo muajit (jo më larg se ditën e pestë të muajit) në Ministri (divizionin për kontroll teknike të automjeteve), dhe dërgohen në formë të shkruar apo në formë elektronike.

Neni 33

Kontrollimi periodik gjashtë mujor

1. Vërtetimi (kartoni) i kontrollimit teknik periodik gjashtë (6) mujor i automjetit duhet të përmbajë:

- 1.1. Emrin e Qendrës.
- 1.2. Numrin e regjistrimit nga libri i evidencës.
- 1.3. Datën e kryerjes së kontrollimit teknik.
- 1.4. Të dhënat mbi automjetin (tabelat, markën, tipin dhe numrin e shasisë).
- 1.5. Të dhënat e subjektit në emër të cilit i lëshohet vërtetimit .

2. Kartoni periodik 6 (gjashtë) mujor i kontrollimit periodik të lëshohet me numër rendor të librit të evidencës, po ashtu me rastin e lëshimit të këtij kartoni të lëshohet edhe certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të automjetit me të njëjtin numër rendor, në rubrikën e vërejtjes të konstatohet që është kontroll periodike.

3. Kartonin periodik duhet të plotësohet me kompjuter të cilin e nënshkruan dhe vulos udhëheqësi i qendrës ose personi i autorizuar i cili e zëvendëson dhe në librin e evidencës evidentohet që është kontrollim teknik periodik dhe i njëjti lëshohet edhe me rastin e kontrollimit teknik të rregullt.

Neni 34

Koha e nevojshme për kontrollimin e automjeteve

Koha e nevojshme për kryerjen e kontrollimeve teknike sipas kategorive të automjeteve është:

- 1.1. Për kontrollimin teknik të automjetit me masë deri në 3.5 t është 20 minuta.
- 1.2. Për kontrollimin teknik të automjetit me masë mbi 3.5 t është 40 minuta.
- 1.3. Për kontrollimin teknik të motoçikletës, rimorkios së lehtë është 18 minuta.
- 1.4. Për kontrollimin teknik të rimorkios së rëndë është 45 minuta.
- 1.6. Për kontrollimin teknik periodik të pneumatikëve, të frenit punues, frenit ndihmës, të autobusit, kamionit, rimorkios dhe gjysmë rimorkios është 40 minuta.

Neni 35

Përcaktimi i maksimumit

1. Qendra nuk mund të kryej më tepër se njëzetë e gjashtë (26) kontrollime teknike të automjeteve me masë deri në 3,5 t brenda orarit të punës.

2. Qendra nuk mund të bënë më tepër se dymbëdhjetë (12) kontrollime teknike të automjeteve me masë mbi 3.5 brenda orarit të punës.

3. Qendra nuk mund të bënë më tepër se njëzetë e gjashtë (26) kontrollime teknike të motoçikletave brenda orarit të punës.

Neni 36

Vendi i kryerjes së kontrollimit teknik

1. Kontrollimi teknik i automjetit duhet të kryhet në qendrën e cila është në territorin e kuvendit komunal banor i të cilës është pala.

2. Nëse në territorin e kuvendit komunal banor i të cilit është pala nuk ka qendër ose i mungon vija për kontrollimin e kategorisë përkatëse, të licencuar, atëherë kontrollimi teknik kryhet në qendrën më të afërt por jo jashtë territorit të regjionit në të cilin është pala.

3. Përfshirë nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni bëjnë motoçikletat.

4. Qendra ka të drejtë të bëjë marrëveshje me subjektet juridike publike apo private për ofrimin e shërbimit të kontrollit teknik të cilat nuk bëjnë pjesë në territorin e Kuvendit Komunal në të cilin është Qendra.

5. Në rastet e paraqitura në paragrafin 4 të këtij neni Qendra obligohet të njoftojë Ministrinë/Inspektoratin.

Neni 37

Orari i punës

1. Qendra punon pesë ditë në javë (e hënë – e premte).

2. Vikendet (dita e shtune-diele) dhe festat shtetërore nuk janë ditë pune, Departamenti Automjeteve është i obliguar të njoftoj Qendrat për festat shtetërore.

3. Orari i punës është prej ora 8:00 deri në ora 17:00.

4. Në raste të jashtëzakonshme me vendimin e ministrisë qendra ka mundësi të mos ju përmbahet kushteve të përcaktuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 38

Obligimi për respektim të çmimores

1. Qendrat janë të obliguara të iu përmbahen çmimores për kontrollimin teknik të automjeteve e cila është në fuqi dhe është unike, për çdo mos përfillje të saj do të merren masa adekuate ligjore.

Licencimi dhe përtëritja e licencës së Qendrës

Neni 39

Kushtet për Licencim

Për tu pajisur me licencë për kryerjen e kontrollimit teknik subjekti duhet të posedon, hapësirën, objektin, pajisjet dhe personelin për kryerjen e kontrollit teknik sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 02/L-70 Për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor dhe këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 40

Objekti i qendrës të kontrollimit teknike

1. Objekti i qendrës duhet të jetë i ndërtuar prej materialit të fortë, i tipit kalues me hyrje dhe dalje të veçantë në një vijë, dritare, çati, i betonuar apo asfaltuar, dyshemeja duhet të mundësojë kalueshmëri për automjetet e të gjitha dimensioneve.

2. Objekti i qendrës duhet të ketë zyrën e administratës, sportelin, nyjën sanitare dhe hapësirën për palë.

Neni 41

Hapësira e qendrës të kontrollimit teknik

1. Qendra për ofrimin e shërbimit të kontrollimit teknik të automjeteve duhet të ketë hapësirë të mjaftuar para dhe pas objektit për të siguruar qasje të lehtë në hyrje dhe dalje.

2. Hapësira minimale duhet të jetë :

2.1. Për automjetet me masë deri në 3.5t, 15m para hyrjes në objekt dhe 10m në dalje të objektit;

2.2. Për automjetet me masë mbi 3.5t, 25m para hyrjes në objekt dhe 15m në dalje të objektit.

3. Sipërfaqja brenda Qendrës duhet të jetë e asfaltuar, betonuar ose e punuar prej materialit të fortë dhe e niveluar.

Neni 42

Pajisjet për kryerjen e kontrollimit teknik të automjeteve deri në 3.5 ton

Për kryerjen e kontrollimit teknik të automjeteve me masë deri në 3,5t, qendra duhet të ketë:

1.1. Kanalin me gjatësi së paku prej 8m dhe gjerësi 0.8 deri 0.9m me kufizues 0,05 m dhe i ndriçuar ose vinçin ngritës me masë jo më të vogël se 2.5t;

1.2. Cilindrat për kontrollimin e forcës së frenimit për automjetet me masë deri në 3.5t duhen të jenë me lidhje me dy motorë, me mundësi të paraqitjes analoge të forcës së frenimit për anën e majtë dhe të djathtë, dhe treguesin për paraqitjen e dallimit në mes të anës së majtë dhe të djathtë në përqindje (%);

1.2.1. Cilindrat duhet të mundësojnë matjen e forcës së frenimit prej 0-6KN, kontrollin e ovalitetit dhe llogaritjen automatike të forcës së frenimit në rrotat e boshtit të njëjtë;

1.2.2. Elektro frenat për dalje më të lehtë prej kanalit;

1.2.3. Sistemin për kontrollimin e matjes së forcës së frenimit te automjetet që kanë sistemin tërheqës 4x4.

1.3. Telekomandën me papuçe (dinamometër) për kontrollimin e forcës maksimale të frenimit në pedale;

1.4. Pajisjen për testimin e amortizatorëve me dy elektromotorë ku tregon amplitudën në përqindje(%);

1.4.1. Pajisja duhet të jetë e lidhur me kompjuter;

1.4.2. Pajisja duhet të ketë peshoren për matjen e masës së automjetit sipas boshtit.

1.5. Pllakën shkelëse të automjeteve me masë deri në 3.5 t, e lidhur në kompjuter;

1.6. Pllakat hidraulike për verifikimin e rregullsisë (mollëzës, lidhëses, pirunit etj) te automjeti me masë deri në 3.5 t;

1.7. Vinçin pneumatik të instaluar në kanal me masë prej 2 t, me mundësi të ngritjes në lartësi deri në 0.6 m;

1.8. Pajisjen për matjen e gazrave hudhëse (CO, CO₂, HC, NO_x) të automjetit i cili duhet të ketë mundësinë për matjen e numrit të rrotullimeve të motorit dhe temperaturën e vajit të të gjitha llojet e motorëve, i njëjti duhet të jetë i lidhur me kompjuter;

1.9. Pajisjen për matjen e gazrave hudhëse te diessel motorët i cili duhet të jetë i lidhur me kompjuter;

1.10. Pajisjen për matjen e temperaturës së vajit të frenimit si dhe shkallën e vlimit i cili duhet të jetë i lidhur me kompjuter;

1.11. Pajisjen për testimin e automjetit i cili nuk mund të testohet në cilindrat për frenim me mundësi të matjes të forcës së frenimit, papuçen për matjen e forcës në pedale kontrollimin e shtypjes së ajrit me mundësi të printimit;

1.12. Pajisjet për ventilimin e gazrave derisa automjeti gjendet në vijën e kontrollimit teknik me kapacitet thithës prej 900-1200 m³/h;

1.13. Pajisjen për matjen e gjatësisë dhe forcës së dritave me nivelizim prej 0-6% të lidhur në kompjuter, pasqyrat për rregullimin e dritave të automjetit;

- 1.14. Pajisjet për matjen e hapit të lirë të timonit;
- 1.15. Pajisjen për matjen e zhurmës i cili duhet të jetë i lidhur me kompjuter;
- 1.16. Pajisjen për matjen e thellësisë të profilit të gomave;
- 1.17. Katalogun me ngjyra;
- 1.18. Metrin ose shiritin metrik;
- 1.19. Kompresorin me manometër;
- 1.20. Kronometrin.

Neni 43

Pajisjet për kryerjen e kontrollimit teknik të automjeteve në masë mbi 3.5 ton

Për kryerjen e kontrollimit teknik të automjeteve me masë mbi 3,5t, qendra duhet të ketë:

- 1.1. Kanalin me gjatësi së paku prej 18m i pajisur me ndriçim dhe kufizues me lartësi prej 8cm, gjerësia e kanalit duhet të jetë 90cm deri 100 cm;
- 1.2. Cilindrat për kontrollimin e forcës së frenimit për automjete me masë deri në 15t me lidhje dy motorë, me mundësi të paraqitjes analoge të forcës së frenimit për anën e majtë dhe të djathtë, treguesin për paraqitjen e dallimit në mes të anës së majtë dhe të djathtë në përqindje (%) matjen e ovalitetit dhe llogaritjen automatike të forcës së frenimit në rrotat e boshtit të njëjtë;
 - 1.2.1. Elektro frenat për dalje më të lehtë prej kanalit;
 - 1.2.2. Cilindrat duhet të kenë kompjuterin personal i cili tregon të gjitha matjet e duhura dhe si shtesë paraqitjet analoge të forcës së frenimit për anën e majtë e të djathtë dhe treguesin për paraqitjen e dallimit në mes të anës së majtë dhe të djathtë në %;
 - 1.2.3. Cilindrat për kamionët të cilët mundësojnë matjen e forcës së frenimit prej 0-30 kN;
 - 1.2.4. Cilindrat duhet të kenë sensorët për kontrollimin e shtypjes së ajrit në rezervar;
 - 1.2.5. Versioni i kanalit duhet të ketë sistemin sigurues për ndalimin e punës së cilindrave nëse punëtori i autorizuar gjendet në kanal;
- 1.3. Telekomandën me papuçe (dinamometër) për kontrollimin e forcës së frenimit;
- 1.4. Pllakën shkelëse deri në 15 t;

- 1.5. Pllakën hidraulike për kontrollin e sistemit të vozitjes (mollëzat, lidhëset, pirunët, gjysmëaksit) deri në 18t të ngarkesës së boshtit i cili mundëson gjatë kthimit të drejtimit;
- 1.6. Në kanal duhet të ketë të instaluar vinçin pneumatik prej 15 t;
- 1.7. Pajisja për matjen e gazrave te diessel motorët e lidhur me kompjuter ;
- 1.8. Pajisjen për matjen e vajit për frenim (glicerinës) se frenave i cili tregon temperaturën e avullimit ;
- 1.9. Pajisjen për matjen e gazrave hudhëse (CO, CO₂, HC, NO_x) të automjetit i cili duhet të ketë mundësinë për matjen e numrit të rrotullimeve të motorit dhe temperaturën e vajit te të gjitha llojet e motorëve, i njëjti duhet te jetë i lidhur me kompjuter;
- 1.10 Pajisjen për testimin e frenave tek automjetet te cilët nuk munden të testohen në cilindra;
- 1.11. Aparati duhet të ketë të instaluar printerin për printim papuçen për matjen e forcës në pedale, kontrollimin e shtypjes se ajrit dhe të jetë i lidhur me kompjuterë;
- 1.12. Në hyrje dhe dalje duhet të jenë dyert me gjerësi 4.0 m dhe lartësi 4.4 m;
- 1.13. Pajisjet për ventilimin e gazrave deri sa vetura (kamioni) gjendet ne fazën e matjes së gazrave, dhe kalimin e ajrit në gypin thithës prej 1700-2300 m³ /h;
- 1.14. Aparatin për matjen e gjatësisë dhe forcës së dritave me nivelizim prej 0-6% të lidhur në kompjuter, pasqyrat për rregullimin e dritave të automjetit;
- 1.15. Pajisjen për matjen e hapit të lirë të timonit;
- 1.16. Aparatin për matjen e zhurmës;
- 1.17. Matësin e thellësisë së profilit të gomave;
- 1.18. Katalogun e ngjyrave ;
- 1.19. Metrin ose shiritin metalik;
- 1.20. Kompresorin me manometër;
- 1.21. Kronometrin.

Neni 44

Pajisjet për kryerjen e kontrollimit teknik të motoçikletave

Për kontrollimin teknik të motoçikletave, qendra duhet të ketë:

- 1.1. Cilindrat për testimin forcës së frenimit të lidhur me kompjuter me forcën matëse prej 0-2.5 KN;
- 1.2. Paraqitjen analoge të forcës së frenimit;
- 1.3. Peshoren për matjen e masës;
- 1.4. Telekomanduesin me papuçe në frenin e dorës dhe të këmbës i lidhur në kompjuter;
- 1.5. Cilindrat për testimin e shpejtësisë të montuar me simulator të ngarkesës së ajrit i cili funksionon në tolerancën prej 25-75km/h;
- 1.6 .Shkallët anësore për siguri gjatë testimit.

Neni 45

Personeli i qendrës së kontrollimit teknik

1. Qendra duhet të ketë së paku dy kontrollues të punësuar dhe të licencuar për një vijë të kontrollimit teknik.
2. Personeli i Qendrës së kontrollimit teknik të automjeteve duhet përveç kushteve të parapara me ligj të plotësojë edhe këto kushte:
 - 2.1. Udhëheqësi i Qendrës duhet të ketë të kryer fakultetin teknik ose shkollën e lartë, drejtimi i makinerisë, elektroteknikës, komunikacionit dhe së paku një (1) vit përvojë pune;
 - 2.2. Kontrolluesi i automjeteve duhet të ketë të kryer shkollën e mesme teknike, drejtimi makinerisë, automekanik, autoelektricit, komunikacionit dhe së paku një (1) vit përvojë pune në servisimin e automjeteve.

Neni 46

Procedura për marrjen e pëlqimit për hapjen e qendrës të kontrollimit teknik

1. Ministri planifikon dhe vendos për hapjen e Qendrave të reja.
2. Kriter për licencimin e Qendrave të reja është nëse në një vendbanim arrihet shifra prej pesmijë (5000) automjeteve apo nëse mesatarja vjetore e kontrollimeve teknike të automjeteve e kalon shifrën prej pesmijë (5000) automjeteve për një Qendër në kuadër të një komune
3. Vendimi për hapjen e Qendrave të reja publikohet në mjetet e informimit.
4. Për marrjen e pëlqimit për hapjen e qendrës për kontrollim teknike të automjeteve subjekti duhet të paraqet:
 - 4.1. Kërkesa me të dhënat (emrin e mbiemrin e pronarit, emërtimi i subjektit, vendi, adresa e saktë, numri i telefonit. dhe emaili);

4.2. Certifikata e regjistrimit të biznesit me veprimtarinë e kontrollimit teknik (e veçantë);

4.3. Dëshmia mbi pronësinë (kopja e planit dhe certifikata e pronësisë, jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj ose kontratën për qiranë të vertetuar në Gjykatë.

5. Palët për marrjen e pëlqimit për kontrollim teknik të automjeteve do të marrin përgjigje në afat prej nëntëdhjetë (90) dite prej ditës të paraqitjes të kërkesës.

6. Pala e cila merr pëlqimin për hapjen e kontrollimit teknik duhet objektin ta ndërtoi brenda gjashtë (6) muajve nga dita e marrjes të pëlqimit

7. Pas ndërtimit të objektit dhe vendosjes të pajisjeve njofton Ministrinë për pranim teknik të objektit.

Neni 47

Dokumentacioni për pranim teknik

1. Për pranimi teknik të objektit subjekti dorëzon dokumentacionin në vijim:

1.1. Kërkesën;

1.2. Lejen e punës të lëshuar nga Kuvendi Komunal;

1.3. Planin e objektit me infrastrukturë përcjellëse;

1.4. Regjistrin e pajisjeve për kontrollim teknik;

1.5. Regjistrin e personelit (kontratat e punës, përgatitjen profesionale, përvojën e punës dhe patentë shoferin).

2. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Ministri në dy (2) kopje kurse gjatë verifikimit prezantohet origjinali.

Neni 48

Procedurat për pranim teknik

1. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Departamentin e Automjeteve-Divizionin e kontrolles teknike.

2. Komisioni i emëruar nga Ministria bënë vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimin e gjendjes në teren.

3. Nëse komisioni konstaton se subjekti nuk ka plotësuar kushtet për licencim dhe nuk e ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, atëherë mund t'i lejohet një afat plotësues për plotësimin e dokumentacionit.

4. Ministri brenda tridhjetë (30) dite nga pranimi i teknik i objektit duhet ta pajisë subjektin me licencë.

Neni 49 Lëshimi i licencës

1. Licencën e lëshon Ministri.
2. Me rastin e marrjes së licencës apo përtëritjes së saj Qendra do të paguaj tarifën si vijon:
 - 2.1. Për vijën e kontrollimit teknik të automjeteve deri në 3.5 t 4000 €;
 - 2.2. Për vijën e kontrollimit teknik të automjeteve mbi 3.5 t 2.500 €;
 - 2.3. Për vijën e kontrollimit teknik të motoçikletave 500 €;
3. Licenca lëshohet në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjet.
4. Licenca nuk mund të tjetërsohet te subjekti tjetër pa pëlqimin e Ministrisë.
5. Qendra e cila është e licencuar për kryerjen e kontrollimeve teknike deri në 3.5 t ka të drejtë të aplikoj për licencim mbi 3.5 t dhe Qendra e cila është e licencuar mbi 3.5 tonë ka të drejtë të aplikoj për marrjen e licencës për kryerjen e kontrollimeve teknike deri në 3.5 t
6. Departamenti i Automjeteve – Divizioni i kontrollimit teknik do të mbajë regjistrin dhe një kopje të licencave.

Neni 50 Përtëritja e licencës

1. Qendra e kontrollimit teknik nëntëdhjetë (90) ditë para skadimit të afatit të vlefshmërisë së licencës duhet të parashtoj kërkesë për përtëritjen e saj.
2. Kërkesës për përtëritje të licencës subjekti përveç dokumentacionit të përcaktuara në nenin 47 të këtij Udhëzimi Administrativ duhet të bashkangjesë edhe dëshminë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave që nuk ka pengesa të natyrës administrative-fiskale për ushtrimin e veprimtarisë (në origjinal);
3. Vlerësimin e performancës së Qendrave e bënë një komision i emëruar nga Ministri.

Neni 51 Refuzimi i kërkesës për licencim

Kërkesa për marrjen e licencës refuzohet kur:

- 1.1. Nuk i plotëson kriteret dhe kushtet e përcaktuara për licencim;

- 1.2. Ka paraqitur informacion jo të vërteta në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës.
- 1.3 Performanca e pesë viteve të fundit ka rezultuar negative.

Neni 52 **Detyrimet e Qendrës**

Qendra është e obliguar si vijon:

- 1.1. Objektin dhe pajisjet për kryerjen e kontrollimit teknik të automjeteve të mirëmbajë rregullisht dhe të jenë në gjendje të rregullt për përdorim;
- 1.2. Një herë në vit të bëjë kalibrimin (bazhdarimin) e pajisjeve;
- 1.3. Gjatë kryerjes së kontrollimit teknik të automjetit i njëjti inspektues nuk mund të angazhohet në dy vija të kontrollimit teknike në të njëjtën kohë;
- 1.4. Për ndryshimet e bëra në personel, njofton Ministrinë (Divizionin për kontroll teknike) në afat prej tri (3) ditë (me kontratën e punës-origjinal, kualifikimin shkollor, përvojën e punës, kopjen e letërnjoftimit dhe kopjen e patentë shoferit);
- 1.5 Personeli i qendrës duhet të ketë uniform unike dhe kartën identifikuese (ID) e cila duhet të përmbajë (emrin dhe mbiemrin, pozitën e punëtorit, dhe logon e subjektit).

Neni 53 **Pezullimi i licencës**

1. Ministria pezullon licencën, duke ndërprerë për një periudhë të caktuar kohe veprimtarinë në rastet kur:

- 1.1. Kërkohet me vendim të gjykatës, deri në marrjen e vendimit përfundimtar;
- 1.2. Bën kontrollimin teknik të automjeteve me pajisje të cilat nuk plotësojnë kushtet e caktuara;
- 1.3. Nuk mban në rregull dokumentacionin dhe evidencën;
- 1.4. Nuk dorëzon raportet e punës në Ministri në kohën e caktuar;
- 1.5. Nuk respekton orarin e punës;
- 1.6. Nuk i përmbahet kohës së caktuar për kryerjen e kontrollimit teknik;
- 1.7. Nuk lajmëron ndërrimin e personelit;
- 1.8. Nuk mbyll librin e evidencës në përfundimin e orarit të punës;

- 1.9. Libri i evidencës, formulari i procesverbalit, certifikata dhe kartoni periodik nuk kanë formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga Ministria;
 - 1.10. Vepron në kundërshtim me nenin 27 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/13 për kontrollimin teknik të automjeteve;
 - 1.11. Nëse kryen kontrollimin teknik në kundërshtim me nenin 36 të Udhëzimit Administrativ nr 2008/13 për kontrollimin teknik të automjeteve;
 - 1.12. Nuk e respekton çmimoren për kontrollimin teknik të automjeteve e cila është në fuqi dhe është unike.
2. Pezullimin e licencës e bën Ministri apo një komision i autorizuar nga ai.
 3. Ministri brenda afatit prej tre (3) ditë emëron komisionin i cili do të shqyrton propozimin e inspektorit për pezullim të licencës.
 4. Nëse vërtetohet se kërkesa e inspektorit është e bazuar se Qendra është, përgjegjëse për shkelje ligjore Ministri apo komisioni i emëruar nga ai merr vendim për pezullim të licencës.

Neni 54 **Revokimi i licencës**

1. Licenca revokohet nga Ministri nëse qendra e kontrollimit teknik të automjeteve:
 - 1.1. Lëshon vërtetim për rregullsinë teknike për automjetin i cili nuk ka qenë teknikisht në gjendje të rregullt;
 - 1.2. Lëshon vërtetimin për rregullsinë teknike për automjetin i cili nuk ka qenë në qendrën e kontrollimit teknik;
 - 1.3. Ndërhyn në programin e rregullsisë teknike dhe kohën;
 - 1.4. Vërtetohet se ka sjell dëshmi të falsifikuara për licencim;
 - 1.5. Vepron në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
 - 1.6. Revokimi i licencës mund të bëhet edhe me kërkesën e Qendrës.
2. Propozimin për iniciimin e procedurës për revokimin e licencës e bën organi i inspektoratit.
3. Ministri emëron komisionin, i cili do të shqyrtoj propozimin dhe do të vlerësoi nëse propozimi, për iniciim të procedurës për revokim të licencës është i bazuar dhe do të propozoj Ministrin marrjen e vendimit për revokimin e licencës apo hedhjen poshtë të propozimit të inspektoratit.

Neni 55

Zëvendësimi dhe ndërrimi i pronarit të licencës

1. Zëvendësimi i licencës bëhet me kërkesë të subjektit për rastet kur deklarohet e humbur, e vjedhur ose e dëmtuar.
2. Për zëvendësimin e licencës sipas paragrafit 1 të këtij neni lëshohet vërtetim deri në kryerjen e verifikimit nga Ministria.
3. Pas kryerjes së verifikimit, lëshohet duplikati i licencës.
4. Ndërrimi i pronarit të licencës apo lokacionit duhet të bëhet me pëlqimin e Ministrisë.

Neni 56 Ankimi

1. Pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë në Ministri.
2. Ankesa mund të parashtrohet në bazë të Ligjit mbi Procedurën Administrative në fuqi.
3. Kundër vendimit të Komisionit të Ministrisë në lidhje me ankesën mund të filloj procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente.

Neni 57 Të hyrat

Të hyrat e krijuara sipas këtij Udhëzimi Administrativ i derdhen në Buxhetin e Republikës të Kosovës.

Neni 58 Dispozita kalimtare

1. Neni 24 dhe 25 të këtij Udhëzimi Administrativ do të zbatohet deri në momentin e dhënies së autorizimit.
2. Paragrafi 2 dhe 3 i Nenit 27 të këtij Udhëzimi Administrativ do të jenë në fuqi derisa fillon sistemi on-line dhe incizimi të bëhet me kamera.
3. Paragrafi 1 i nenit 36 do të jetë në fuqi derisa të fillon të zbatohet sistemi on-line dhe incizimi të bëhet me kamera.

Neni 59 Dispozitat shfuqizuese

Ky Udhëzim Administrativ shfuqizon Udhëzimin Administrativ 2006/10 Për kontrollimin teknik të automjeteve dhe Udhëzimin Administrativ 2007/5 për plotësimin e Udhëzimin Administrativ 2006/10 Për kontrollimin teknik të automjeteve.

Neni 60
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi prej 1 Janarit të vitit 2009..

Fatmir Limaj,

Ministër i Transportit dhe Postë Telekomunikacionit

Datë _____.